



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 2 Datë 10.05.2007

PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS SË HUAPËRDORJES DHE PËRBALLIMIT
TË SHPENZIMEVE NGA BASHKIA KORÇË PËR ENERGJI ELEKTRIKE
DHE UJË PËR QENDRËN KOMUNITARE ME SHËRBIM KOPSHTI

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës "PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË HUAPËRDORJES DHE PËRBALLIMIT TË SHPENZIMEVE NGA BASHKIA KORÇË PËR ENERGJI ELEKTRIKE DHE UJË PËR QENDRËN KOMUNITARE ME SHËRBIM KOPSHTI", bazuar në ligjin nr 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore" neni 10, pika II/c. neni 32. pika dh. Udhëzimin nr 2 dt 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007". Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 i Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007". V.K.B. nr 2 dt 02.02.2007 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të varësishme për vitin 2007" dhe në marrëveshjen e lidhur me datë 19.09.2006 midis Bashkisë Korçë dhe Qendres Komunitare me shërbim kopshti të Komunitetit Rom, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve.

VENDOSI

1. Të miratohet kontrata e huapërdorjes midis Bashkisë Korçë dhe Qendres komunitare me shërbim kopshti e komuniteti rom si dhe fondin prej 54.400 lekë për përballimin e shpenzimeve të konsumit të energjisë elektrike dhe ujit për vitin 2007, për Qendrën me shërbim kopshti të komunitetit rom. Hëkteret financiare fillojnë pas miratimit të vendimit në Këshillin Bashkiak.
2. Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar i shpenzimeve operative të bashkisë, në zërin shpenzime të tjera, duke pakësuar fondin në këtë zë nga 900.000 lek i planifikuar, në 845.600 lek, me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet	00	01110	05	Art 6020000	- 54.400 lekë
Shtohet	00	09120	05	Art 6020000	+54.400 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Personelit dhe Protokoll Arkives dhe Mbeshtetjes te Bashkise, Drejtoria Mbeshtetëse e Arsimit dhe Qendra me shërbim kopshti e komunitetit rom.

Kryetare e Këshillit

Rajmonda NASE